



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4114 prot.

Fushë-Arrëz, më 30.12.2025

VENDIM
Nr. 48, datë 26.12.2025

“PËR
TRAJTIMIN ME BURSË TË NXËNËSVE TË SHKOLLAVE TË MESME
PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026”

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; VKM- së 666, datë 10/10/2019, i ndryshuar (VKM Nr. 511, datë 27.7.2022) “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, shkresës me nr. 973/1prot. datë 29.10.2025 të Ministrisë Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit-Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Punësimit, Aftësimit dhe Sigurimeve Shoqërore, mbi “Plani i shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin klasën e 10-të në shkollat e mesme të arsimit profesional publik për vitin shkollor 2025-2026, **Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz në mbledhjen e tij të datës 26.12.2025**, pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura nga Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz,

VENDOSI

1. Të trajtohen me bursë të plotë nxënësit e vitit të parë, në shkollat e arsimit të mesëm profesional, për vitin shkollor 2025-2026, bazuar në VKM- së 666, datë 10/10/2019, i ndryshuar (VKM Nr. 511, datë 27.7.2022) “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike” *sipas tabelës bashkëngjitur*.
2. Ky vendim bëhet publik në faqen zyrtare të institucionit për nxënësit, komunitetin, median dhe institucionet e tjera.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen shkollat përkatëse.

Ky vendim u zbardh me datë **30.12.2025** dhe hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

14 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU



Nr	Emër Atësi Mbiemër	Shkolla	Qyteti	Dega	V/banimi	Niveli i bursës	Kriteret e përfitimt sipas VKM 666, datë 10.10.2019
1.	Mirgen Gzim Mhilli	Shkolla e Mesme Industriale “Arben Broçi”	Shkodër	Shkolla e Mesme Teknike	Iballë	E Plotë	Kriteri 2.1 pika a)
2.	Indrit Gjon Malaj	Shkolla e Mesme Profesionale Bujqësore Kamëz	Kamëz	Shërbime Mjetesh Transporti	Iballë	E Plotë	Kriteri 2.4 pika a)
3.	Erion Gezim Marku	Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz	Kamëz	Hoteleri-Turizëm	Iballë	E Plotë	Kriteri 2.1 pika a)

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

